



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 18 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Arsim Bajrami, Mufera Şinik, Behar Selimi, Halit Krasniqi, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Haki Demolli dhe Jasmina Zhivkoviç.

Mungoi: Ardian Gjini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Floriana Shala – OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Arben Shamolli – ISKP, Yll Zekaj – OAK, Musa Dragusha – OAK, Reshit Gashi – NDI, Naim Hajdari – EULEX.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.05.2012;
3. Shqyrtimi i Projektregullores së Kuvendit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/I-006 për procedurën kontestimore;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që si pikë e rendit të ditës të radhitet edhe kërkesa e organizatës “ Çohu “, ndërsa me sugjerim të Armend Zemaj të hiqet nga rendi ditës pika e tretë.

Albulena Haxhiu – Ishte kundër që pika e tretë të hiqet nga rendi i ditës pasi që e kemi pasur me kohë materialin e rregullores dhe kemi pasur mjaft kohë.

Rendi ditës u miratua me ndryshime dhe pika e tretë hiqet nga rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.05.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23. 05. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore

Halit Krasniqi – E prezantoi punën e grupit punues dhe e njoftoi komisionin se Oda e Avokatëve ka sjellë një propozim dhe meqë nuk e kemi pasur me kohë, kërkoi që të hiqet nga rendi ditës dhe të mbahet edhe një takim i grupit punues.

Komisioni vendosi që pika e tretë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e organizatës “ Çohu “ dhe vendosi që të kërkojë nga Agjencia Kundër Korrupsionit formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë të kësaj agjencie.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit